# Rregulla e Urdhrit Françeskan Shekullar

**e miratuar nga Papa Gjon Pali II**

**më 24.06.1978** [1]

## Parathënie

Urdhri Françeskan Shekullar (UFSH) është Urdhri i Tretë, që e themeloi shën Françesku i Asizit (1182-1226), në vitin 1221 – për besimtarët e thjeshtë, familjarë, njerëz të martuar, që nuk mund të braktisin botën dhe familjen e vet për t'iu kushtuar plotësisht Zotit dhe Kishës, por Zotit dhe Kishës i shërbejnë dhe përpiqen rreth përsosmërisë dhe shenjtërimit personal brenda familjeve të veta dhe në vendin e vet të punës.

Megjithëse ky Urdhër në botë ekziston që nga viti 1221, ai në popullin shqiptar, në kohën e sundimit turk, ishte zhdukur krejtësisht. Në Shkodër është ripërtërirë më 28.12.1866, kurse në Gjakovë vetëm disa muaj më vonë – në vitin 1867.

Në Gjakovë UFSH-$^{\text{-në}}$ e ripërtëriu Atë Gaudens Barbiq, frat i Dubrovnikut. Punën e tij e vazhduan Atë Rosario, Atë Emilio Gabos a Cles (Themelues i Shenjtërores së Shën Antonit në Gjakovë), Atë Metod Mjekajsh, pastaj martiri ynë Atë Luigj Paliq, Atë Gjon Blushaj, Atë Shtjefën Gjeçovi dhe Atë Lorenc Mazrreku, të cilin e pushkatuan, më 15.02.1943.

Sa e gjallë ishte kjo bashkësi, tregon edhe fakti se vetëm më 8 shtator 1916 Atë Gjon Blushaj dhe Atë Marjan Prela kanë pranuar në UFSH 63 anëtarë të rinj. Por, mjerisht, pas Luftës II botërore, kur komunizmi i ndaloi të gjitha organizatat shoqërore fetare, u fik edhe Urdhri Françeskan Shekullar.

Tani, më në fund – me ndihmë të Zotit – ky Urdhër ripërtërihet. Zoti ia dhashtë lulëzimin e vazhdueshëm dhe frytet e begatshme!

---

[1] *Korrigjimi letrar dhe përpunimi grafik:* Nikolin Sh. Lëmezhi, Angjelin N. Ndoka, Kristian F. Gjokhilaj.

# NXITJE E SHËN FRANÇESKUT

**vëllezërve dhe motrave pendestare**

Në emër të Zotit!

## Për ata që bëjnë pendesë

Të gjithë ata që e duan Zotin me gjithë zemër, me gjithë shpirt e mendje, me gjithë forcë (krh. Mk. 12, 30) dhe i duan të afërmit si vetveten (krh. 22, 39), dhe i urrejnë trupat e vet me vese e mëkate, dhe marrin Trupin e Gjakun e Zotit tonë Jezu Krishtit, e japin fryte të denja pendese (krh. Lk 3, 8): o, sa të lumë e të bekuar janë ata e ato, kur bëjnë gjëra të tilla e qëndrojnë në to! Sepse mbi ta do të pushojë Shpirti i Zotit (krh. Iz 11, 2) dhe tek ata do të qëndrojë e do të banojë (krh. Gjn 14, 23). Ata janë bij të Atit qiellor (krh. Mt 5, 45), veprat e të cilit përmbushin; janë nuse, *vëllezër e nëna* (krh. Mt 12, 50) të Zotit tonë Jezu Krishtit. Nuse jemi kur shpirti besnik bashkohet me Zotin tonë Jezu Krishtin për virtyt të Shpirtit Shenjt. Jemi vëllezërit e tij kur kryejmë v*ullnetin e Atit që është në qiell* (Mt 12, 50). Jemi nëna kur e mbajmë në zemrën e në trupin tonë përmes dashurisë hyjnore dhe ndërgjegjes së pastër e të sinqertë, kur e lindim përmes veprave të shenjta, që duhet t'u shndrisin të tjerëve si shembull (krh. Mt 5, 16).

Oh, sa gjë e lavdishme, e shenjtë dhe e madhe është të kesh një Atë në qiell! Oh, sa gjë e shenjtë, burim ngushëllimi, e bukur dhe e mahnitshme është të kesh një Dhëndër të tillë! Oh, sa e shenjtë dhe e dashur, e këndshme, e përvuajtur, paqësore, e ëmbël, e përzemërt dhe e dëshirueshme përmbi çdo gjë është të kesh një vëlla e një bir të tillë, Zotin tonë Jezu Krishtin, i cili flijoi veten e vet (krh. Gjn 10, 15) për delet e veta, dhe e luti Atin duke thënë: *"O Atë i shenjtë, ruaji në emrin tënd* (Gjn 17, 11) *ata që m'i dhe në botë. Ata ishin të tutë, e ti m'i dhe mua, unë ua dorëzova atyre; e ata i pranuan dhe e besuan se me të vërtetë dola prej teje dhe kuptuan se ti më dërgove* (krh. Gjn 17, 8). *Unë lutem për ta, e jo për botën* (krh. Gjn 17, 9). *Bekoji e shenjtëroji! Për ata unë e shenjtëroj vetveten* (krh. Gjn 17, 17.19). *Nuk pot ë lutem vetëm për këta, por edhe për të gjithë ata që, për shkak të fjalës së tyre, do të besojnë në mua* (Gjn 17, 20), *që të shenjtërohen në Njësi* (krh. Gjn 17, 23)*, që të jenë një sikur ne* (Gjn 17, 11). *Atë, dua që ata të jenë aty ku jam unë, bashkë me mua, që të kundrojnë lavdinë time* (Gjn 17, 24), *në mbretërinë tënde"* (Mt 20, 21). *Amen.*

# Për ata që nuk bëjnë pendesë

Të gjithë ata e ato që, në të kundërt, nuk jetojnë në pendesë, dhe nuk marrin Korpin dhe Gjakun e Zotit tone Jezu Krishtit, e lëshohen në vese e mëkate dhe ecin pas epshit dhe dëshirave të këqija të mishit të tyre, e nuk zbatojnë ato gjëra që i kanë premtuar Zotit, dhe i shërbejnë me trupin e tyre botës, instinkteve epshore e përkujdesjeve të botës e shqetësimeve të kësaj jete: ata janë robër të djallit, bij të të cilit janë, e veprat e të cilit kryejnë (krh. Gjn 8, 41). Janë të verbër, sepse nuk shohin dritën e vërtetë, Zotin tone Jezu Krishtin. Nuk kanë urtinë shpirtërore, sepse nuk e kanë Birin e Hyjit, që është urtia e vërtetë e Atit. Për ta thuhet: *"Urtia e tyre ka dështuar"* (krh. Ps 106, 27), *dhe "Të mallkuar janë ata që iu shmangen urdhërimeve të tua"* (Ps 118, 21). Ata shohin dhe njohin, dine e bëjnë çka është e keqe, dhe me vetëdije e humbasin shpirtin e vet.

Shikoni, o të verbër, të mashtruar nga armiqtë tuaj, domethënë nga mishi, nga bota dhe nga djalli, që trupit i duket gjë e ëmbël të bëjë mëkat dhe gjë e hidhur të nënshtrohet t'i shërbejë Hyjit, sepse të gjitha veset e mëkatet *dalin e rrjedhin nga zemra e njerëzve* (krh. Mk 7, 21; Mt 15, 19), siç thotë Zoti në Ungjill. E nuk keni asgjë në këtë botë, e as në tjetrën. Ju mendoni se do t'i zotëroni për një kohë të gjatë kotësitë e këtij shekulli, por e mashtroni veten, sepse do të vijë dita dhe ora (krh. Mt 24, 44; 25, 13), që ju nuk e pritni, nuk e dini, as nuk e njihni. Trupi sëmuret, vdekja afrohet, e kështu vdiset nga një vdekje e hidhur.

E në çdo vend, kohë e mënyrë, që njeriu vdes në mëkat mortar, pa bërë pendesë e pa larë hakun, nëse mund ta bënte e nuk e ka bërë, djalli e grabit shpirtin e tij nga trupi, me një ankth e mundim kaq të madh, sa askush nuk mund ta dijë, veç atij që e provon.

E të gjitha talentet e fuqia dhe *shkenca e dituria* (krh. 2 Kr 1, 12), që mendonin se zotëronin, do t'u hiqet (krh. Lk 8, 18; Mk 4, 25). E ata ua lënë të gjitha të afërmve dhe miqve. Dhe ja, këta të fundit kanë marrë tashmë dhe ndarë mes tyre pasurinë e tij, e pastaj kanë thënë: "Mallkuar qoftë shpirti i tij, sepse ka mundur të na japë më shumë, e të siguronte më shumë se sa ka siguruar!". Krimbat hanë kufomën, e kështu kanë humbur shpirtin dhe trupin në këtë jetë të shkurtër dhe do të shkojnë në ferr, ku do të mundohen për amshim (krh. Lk 18, 24).

Të gjitha ata që do të marrin këtë letër, i lus, *në dashurinë që është Hyji* (krh. 1 Gjn 4, 16), të pranojnë mirësisht me dashuri hyjnore këto fjalë erëmira të Zotit tonë Jezu Krishtit, që kemi shkruar. E ata që nuk dinë të lexojnë, le të lusin të tjerët që t'ua lexojnë shpesh, e t'i mësojnë përmendësh, duke i vënë në praktikë shenjtërisht, deri në fund, sepse *janë shpirt e jetë* (Gjn 6, 64).

E ata që nuk do ta bëjnë këtë gjë, duhet *të japin llogari ditën e gjykimit, para gjyqit* (krh. Mt 12, 36; krh. Rom. 14, 10) të Zotit tonë Jezu Krishtit.

# Kapitulli I.

## Urdhri Françeskan Shekullar (UFSH)[2]

1. Ndër familjet shpirtërore, të cilat Shpirti Shenjt i ka ngritur në Kishë[3], familja françeskane i bashkon të gjithë ata anëtarë të popullit të Zotit – shekullarët, rregulltarët dhe meshtarët – të cilët ndihen të ftuar që të ecin pas Krishtit gjurmëve të shën Françeskut të Asizit[4].

Ata dëshirojnë në mënyra të ndryshme dhe në forma të ndryshme, por në bashkimin e ndërsjellë të jetës, ta realizojnë karizmën e Atit të përbashkët Serafik në jetën dhe në misionin e Kishës[5].

2. Në familjen e lartpërmendur, vendin e veçantë e ka Urdhri Françeskan Shekullar. Ai formohet si bashkësi organike e të gjitha vëllazërive katolike, që janë përhapur nëpër mbarë botën dhe janë hapur secilës shtresë së besimtarëve. Në këto vëllazëri, vëllezërit e motrat – të nxitur nga Shpirti Shenjt, që të përpiqen rreth përsosurisë në dashuri, në gjendjen e vet shekullare – lidhen me kushte, se do ta jetojnë Ungjillin sikur shën Françesku dhe me ndihmën e Rregullës, të cilën e ka miratuar Kisha[6].

3. Rregulla e tanishme – pas Memoriale Propositi (1221) dhe pas Rregullave, që i kanë miratuar papët Nikolla IV dhe Leoni XIII – e përshtat Urdhrin Françeskan Shekullar nevojave dhe dëshirave të Kishës, në rrethanat e ndryshuara të kohës. Selia e Shenjtë është kompetente që ta shpjegojë Rregullën, e zbatimin praktik do ta përcaktojnë Kushtetutat e Përgjithshme e të veçanta.

---

[2] Quhet edhe "Vëllazëria Shekullare Françeskane", ose "Urdhri i Tretë Françeskan".
[3] Krh. LG 43.
[4] Papa Pio XII, *Fjalimi I° terciarëve, më 01 korrik 1956.*
[5] AA, 4, 8.
[6] Kan. 702, 1 [314].

# Kapitulli II.

## Mënyra e jetës

4. Rregulla dhe jeta e Françeskanëve shekullarë është kjo: të jetojnë Ungjillin e Zotit tonë Jezu Krishtit, duke ndjekur shembullin e shën Françeskut të Asizit, i cili e zgjodhi Krishtin për frymëzues dhe qendër të jetës së vet me Hyjin dhe me njerëzit[7].

   Krishti, dhuratë e dashurisë së Atit, është Rruga, e cila na prin drejt Atit, e Vërteta, në të cilën na drejton Shpirti Shenjt dhe Jeta, të cilën Ai erdhi që të na e japë me begati[8].

   Përveç kësaj, françeskanët shekullarë le të marrin mbi vete detyrën që shpesh do ta lexojnë Ungjillin, duke kaluar nga Ungjilli në jetë dhe nga jeta në Ungjill[9].

5. Prandaj, françeskanët shekullarë le të kërkojnë në vëllezër e motra, në Shkrimin Shenjt dhe në veprat liturgjike, personin e gjallë dhe veprues të Jezu Krishtit. Frymëzim dhe udhërrëfyes në jetën e tyre eukaristike le të jetë feja e shën Françeskut, e cila e nxiti që të shkruajë këto fjalë: *"Nga Biri i Tejetlartë i Hyjit nuk shoh në mënyrë trupore asgjë tjetër, përveç Trupit dhe Gjakut të tij tejet të shenjtë"*.

6. Të varrosur dhe të ringjallur bashkë me Krishtin me anë të Pagëzimit, i cili na bën gjymtyrë të gjalla të Kishës dhe i lidh me të edhe më ngushtë me anë të kushteve, le të jenë dëshmitarë dhe vegla të misionit të saj ndër njerëz, duke e shpallur Krishtin me jetë dhe me fjalë.

   Të frymëzuar me shën Françeskun dhe të ftuar që së bashku me të ta ripërtërijnë Kishën, le të mundohen me zell, që të jetojnë në bashkim të plotë me Papën, ipeshkvijtë dhe meshtarët, duke kultivuar dialogun e hapur dhe besimplotë të frytshmërisë dhe begatisë apostolike[10].

---

[7] 1 Cel. 18, 115.
[8] Gjn. 3, 16; 10, 10; 14, 6.
[9] AA 30, 8.
[10] Papa Pali VI, Fjalimi III° terciarëve, më 19 maj 1971.

7. Si "vëllezër e motra pendestare"[11], për shkak të thirrjes së vet, të tërhequr me fuqinë e madhe të Ungjillit, le ta përshtatin mënyrën e vet të mendimit dhe të veprimit me Jezu Krishtin, me anë të ndryshimit të brendshëm, të plotë dhe të përsosur, të cilit vetë Ungjilli ia jep emrin e "kthimit", i cili – për shkak të ligështisë njerëzore – duhet të zbatohet dita-ditës[12].

   Në këtë rrugë të ripërtëritjes, sakramenti i pajtimit është shenjë e privilegjuar e mëshirës së Atit dhe burim i hirit[13].

8. Sikurse Jezusi ishte adhurues i vërtetë i Atit, po ashtu edhe ata le të mundohen që lutja dhe meditimi të jenë shpirti i jetës dhe i veprimtarisë së tyre[14].

   Le të marrin pjesë në jetën sakramentore të Kishës, sidomos në Eukaristi; dhe le t'i bashkëngjiten lutjes liturgjike në njërën prej formave që i ka propozuar Kisha, duke e përjetuar në këtë mënyrë përsëri misterin e Krishtit.

9. Françesku, me dashuri të patregueshme e donte Virgjërën Mari, shërbëtoren e përvuajtur të Zotit, e cila ishte e gatshme të zbatojë çdo fjalë dhe frymëzim të tij, dhe e ka shpallur Pajtore dhe Mbrojtëse të familjes së vet[15].

   Françeskanët shekullarë le t'ia dëshmojnë dashurinë e vet të zjarrtë nëpërmjet imitimit të gatishmërisë së plotë të zemrës së saj, si edhe nëpërmjet lutjes së përkushtuar dhe të përqendruar[16].

10. Të bashkuar me dëgjesën shpërblyese të Jezusit, i cili vullnetin e vet e ka lënë në duart e Atit, le të zbatojnë besnikërisht detyrat e profesionit të vet në rrethana të ndryshme të jetës[17] dhe le ta ndjekin Krishtin e varfër dhe të kryqëzuar, duke e dëshmuar edhe në vështirësi e persekutime[18].

11. Jezu Krishti, duke shpresuar në Atin, zgjodhi për vete dhe për Nënën e vet jetën e varfër dhe të përvuajtur[19], por megjithatë, me kujdes e dashuri i respektonte krijesat. Po ashtu, edhe françeskanët shekullarë le të mundohen ta kërkojnë qëndrimin e duhur ndaj të mirave tokësore "të shkëputur prej tyre" dhe në

---

[11] [Rregulla e parë e UFSH-së] – Memoriale Propositi.
[12] LG 8; Unitatis redintegratio 4; Paenitemini, Preambula.
[13] PO 18.
[14] AA 4.
[15] 2 Cel. 198.
[16] LG 67; AA 4, 10.
[17] LG 41.
[18] LG 42, 2.
[19] 2 P 5.

përdorimin e tyre, duke i thjeshtësuar nevojat e veta materiale. Pastaj, le të jenë të vetëdijshëm se, sipas Ungjillit, janë mbarështues të të mirave të dhuruara fëmijëve të Zotit.

Kështu le të mundohen që, në shpirtin e "Lumturive" zemrën ta kenë të pastër nga çdo prirje e lakmi për zotërim e pronësim, sepse si "udhëtarë dhe ardhacakë" janë në udhëtim drejt shtëpisë së Atit[20].

12. Si dëshmitarë të të mirave të ardhshme dhe për shkak të thirrjes që e kanë përqafuar, duhet të përpiqen rreth pastërtisë së zemrës, në mënyrë që të bëhen të lirë për dashuri ndaj Hyjit dhe vëllezërve[21].

13. Sikurse Ati në secilin njeri e shikon figurën e të Birit të vet, të Parëlindurit në mes të shumë vëllezërve[22], po ashtu edhe françeskanët shekullarë le t'i pranojnë të gjithë njerëzit me shpirt të përvuajtur dhe mirëdashës, si dhuratë të Zotit[23] dhe si figurën e Krishtit.

    Ndjenja e vëllazërisë do të bëjë që me gëzim dhe gatishmëri të barazohen me të gjithë njerëzit, sidomos me ata që janë më të vegjël, të cilëve do të mundohen që t'ua krijojnë kushtet e jetës, të denja për krijesat që Krishti i ka shpërblyer[24]

14. Janë të thirrur që së bashku me të gjithë njerëzit vullnetmirë ta ndërtojnë botën sa më vëllazërore dhe ungjillore, që të realizohet Mbretëria e Zotit – të vetëdijshëm që "secili që shkon pas Krishtit, njeriut të përsosur, edhe vetë bëhet më tepër njeri". Prandaj le t'i kryejnë detyrat e veta me përgjegjësi të plotë, në shpirtin e krishterë të shërbimit[25].

15. Duke dëshmuar humanitetin e vet dhe me aksione guximtare, qoftë individuale, qoftë të përbashkëta, le të angazhohen në promovimin e drejtësisë, sidomos në sferën e jetës shoqërore, duke marrë mbi vete edhe detyrime reale, në përkim me fenë e vet[26].

---

[20] Rom. 8, 17; LG 7, 5.
[21] Testamenti, XVI; Letra I° të gjithë besimtarëve, 69.
[22] Rom. 8, 29.
[23] 2 Cel 85; Letra II° të gjithë besimtarëve, 26; RrP (Rregulla e pavulosur) VII 15.
[24] RrP IX 3; Mt. 25, 40.
[25] LG 31; GS 93.
[26] AA 14.

16. Punën le ta konsiderojnë si dhuratë të Zotit dhe si bashkëpunim në krijim, shpërblim dhe shërbim ndaj bashkësisë njerëzore[27].

17. Në familjet e veta le të jetojnë me shpirtin e paqes françeskane, në besnikëri dhe me respekt të jetës, duke u munduar që kjo t'u bëhet shenjë e botës, që tashmë është ripërtërirë në Krishtin[28].

    Sidomos, ata që janë të martuar, duke e jetuar hirin e sakramentit të Martesës, le ta dëshmojnë në botë dashurinë me të cilën Krishti e do Kishën e vet. Me një edukim të thjeshtë dhe të çiltër të krishterë le të mendojnë në thirrjen e secilit anëtar, me gëzim le të ecin me fëmijët e vet udhës së përkatëse njerëzore dhe shpirtërore[29].

18. Përveç kësaj, le të respektojnë edhe krijesat e tjera, të gjalla dhe jo të gjalla, sepse edhe ato "e bartin vulën e të Tejetlartit"[30]; dhe le të mundohen që nga tundimi i keqpërdorimit të krijesave të kalojnë në kuptimin françeskan të vëllazërisë së gjithmbarshme.

19. Si bartës të paqes dhe të vetëdijshëm se atë paqe vazhdimisht duhet ta ndërtojmë, le të mundohen, nëpërmjet dialogut, t'i gjejnë rrugët e bashkimit dhe të mirëkuptimit vëllazëror, duke shpresuar në praninë e farës hyjnore që është në njeriun, si edhe në fuqinë shndërruese të dashurisë dhe të faljes[31].

    Si lajmëtarë të gëzimit të përsosur, le të mundohen në çdo rrethanë t'ua sjellin të tjerëve gëzimin dhe shpresën[32].

    Të shartuar në ringjalljen e Krishtit, e cila ia jep kuptimin e vërtetë motrës vdekje, le të përgatiten në mënyrë të qetë për takimin përfundimtar me Atin[33].

# Kapitulli III.

---

[27] GS 67, 2; RrP VII, 4; RrV (Rregulla e Vulosur, e miratuar) V, 2.
[28] Rregulla e Leonit XIII, II, 9; TD 14, 58.
[29] LG 41, 5; AA 30, 2. 3.
[30] 1 Cel. 80; Kënga e Krijesave, 4.
[31] Rregulla e Leonit XIII, II, 9; TD 14, 58.
[32] Testamenti, XXI; RrP VII, 17.
[33] GS 78, 1-2.

## Jeta në vëllazëri[34]

20. Urdhri Françeskan Shekullar ndahet në vëllazëri të niveleve të ndryshme: vëllazëri lokale, krahinore, kombëtare dhe ndërkombëtare – e secila prej tyre në Kishë ka personalitetin e vet moral (juridik)[35].

    Këto vëllazëri të niveleve të ndryshme përshtaten dhe ndërlidhen në mënyrë të ndërsjellë me anë të dispozitave të kësaj Rregulle dhe të Konstitucioneve.

21. Secilën vëllazëri të cilitdo nivel e frymëzon dhe e drejton këshilli dhe ministri [shërbëtori], të cilët i zgjedhin vëllezërit e motrat e kushtuara, sipas Kushtetutave[36].

    Shërbimi i tyre, që është i përkohshëm, është detyrë që duhet ta kryejnë me zemër të përkushtuar e të gatshme, me ndjenjë përgjegjësie për anëtarët individualisht, si edhe për krejt vëllazërinë.

    Për sa i përket organizimit të brendshëm, vëllazëritë organizohen në mënyrë të ndryshme, sipas dispozitave të Konstitucioneve, dhe sipas nevojave të anëtarëve të vet dhe të krahinave, nën drejtimin e këshillit të vet.

22. Vëllazëria lokale duhet të jetë themeluar në mënyrë kanonike. Ajo kështu bëhet qelizë elementare e krejt Urdhrit dhe shenjë e dukshme e Kishës që është bashkësi dashurie. Ajo duhet të jetë vend i privilegjuar, ku do të zhvillohet ndjenja e përkatësisë ndaj Kishës, do të kultivohen thirrjet françeskane dhe do të nxitet jeta apostolike e anëtarëve të saj[37].

23. Kërkesat për pranim në Urdhrin Françeskan Shekullar i drejtohen vëllazërisë lokale, e këshilli i saj vendos për pranimin e vëllezërve e motrave të reja[38].

    Anëtarësimi bëhet me anë të kohës së iniciacionit [formimit fillestar], e kjo kohë formimi duhet të zgjasë të paktën një vit, dhe me anë të kushtimit të Rregullës[39].

    Në këtë rrugë të rritjes shkallë-shkallë është e detyruar krejt vëllazëria në mënyrën e jetës së vet.

---

[34] Fjalën latine "fraternitas" (apo italiane "fraternità") e përkthejmë tekstualisht me fjalën "vëllazëri", mirëpo, me këtë fjalë shprehet realiteti më i gjerë: **"bashkimi i vëllezërve dhe i motrave",** në kuptimin fetar, të krishterë, kishtar dhe françeskan.
[35] Kan. 687 [309].
[36] Kan. 697.
[37] Papa Pio XII, Fjalimi terciarëve, 3, më 01 korrik 1956.
[38] Kan. 694 [307].
[39] Memoriale Propositi 29-30.

Përsa i përket moshës së duhur për dhënien e kushteve dhe për bartjen e shenjës dalluese françeskane[40], duhet të veprohet sipas Statuteve.

Përkushtimi, sipas natyrës së vet, është detyrim i përhershëm[41].

Anëtarët, të cilët bien në vështirësi të veçanta, mund të diskutojnë për problemet e veta në dialog vëllazëror me këshillin e vëllazërisë. Dalja, apo lëshimi përfundimtar, nga Urdhri, në qoftë se ajo është me të vërtetë e nevojshme, është në kompetencën e këshillit të vëllazërisë, sipas dispozitave të Kushtetutave[42].

24. Me qëllim të përforcimit të bashkimit ndërmjet anëtarëve të vëllazërisë, këshilli le të organizojë shpeshherë edhe takimet e jashtëzakonshme me grupe të tjera françeskane, sidomos me të rinjtë, duke u shërbyer me mjete sa më të përshtatshme për rritjen në jetën françeskane dhe kishtare dhe duke nxitur secilin në jetën vëllazërore[43]. E, ky bashkim, le të vazhdojë edhe me vëllezërit e motrat e vdekura, nëpërmjet lutjeve për shpirtrat e tyre[44].

25. Për shpenzimet e rëndomta të jetës së vëllazërisë, si edhe për nevojat e veprave liturgjike, të apostullimit dhe të bamirësisë [karitasit], të gjithë vëllezërit e motrat do të japin kontributin, sipas mundësive të veta. Vëllazëritë lokale le të kujdesohen edhe për mbulimin e shpenzimeve të vëllazërive të shkallës më të lartë[45].

26. Si shenjë konkrete të bashkimit dhe të bashkëpërgjegjësisë, këshillat e niveleve të ndryshme – sipas Kushtetutave – do të kërkojnë rregulltarët e aftë dhe të gatshëm për asistentë shpirtërorë, prej eprorëve të katër familjeve françeskane, me të cilat vëllazëria shekullare ishte e lidhur gjatë shekujve.

Me qëllim të nxitjes së besnikërisë ndaj karizmës dhe ndaj zbatimit të Rregullës, dhe që të fitohet ndihma sa më e madhe në jetën e vëllazërisë, ministri apo kryetari, në marrëveshje me këshillin e vet, sipas dispozitave të Kushtetutave, le të kujdesohet që prej eprorëve kompetentë rregulltarë[46] të kërkojë kohë pas kohe vizitën baritore dhe le të lutë përgjegjësit e shkallës më të lartë për vizitën vëllazërore.

---

[40] 1 Cel. 22.
[41] Krh. Memoriale Propositi, 31.
[42] Kan. 696 [308].
[43] Kan. 697 [309].
[44] Krh. Memoriale Propositi, 23.
[45] Krh. Memoriale Propositi, 20.
[46] Rregulla e Nikollës IV, Kap. 16.

**“E të gjithë ata që do të zbatojnë këtë, le t’i mbushë me bekime në qiell Ati i Tejetlartë, e në tokë le t’i përcjellë me bekime Biri i tij i dashur, së bashku me Shpirtin Tejet të Shenjtë Ngushëllues!”. Amen.**

(Bekimi i Shën Françeskut, nga Testamenti i tij)

**Shtesë:**

## Urdhri Françeskan Shekullar

Urdhri Françeskan Shekullar (UFSH-ja) është organizatë fetare, ndërkombëtare, brenda Kishës Katolike. Ky është Urdhër i Tretë, që e themeloi Shën Françesku i Asizit (1182-1226), në vitin 1221 – për besimtarët e thjeshtë, familjarë, njerëz të martuar, që nuk mund të braktisnin botën dhe familjen e vet për t’iu kushtuar plotësisht përshpirtërisë. Ai përfshin jo vetëm besimtarët laikë, por edhe meshtarët shekullarë (priftërinj) dhe ipeshkvijtë, të cilët dëshirojnë ta jetojnë Ungjillin e Krishtit sipas shembullit të Shën Françeskut të Asizit.

Terciarët, apo françeskanët shekullarë, i kushtohen shërbimit të Hyjit dhe të Kishës brenda familjeve të veta dhe në vendin e vet të punës.

Ata, secili në gjendjen e vet:

- jetojnë Ungjillin e Zotit tonë Jezu Krishtit,
- përpiqen rreth përsosurisë në jetën e pastër të krishterë,
- punojnë për paqe dhe për drejtësi në të gjitha aspektet e jetës,
- në mënyrë paqësore dëshmojnë fenë, shpresën dhe dashurinë e vet ndaj Zotit dhe ndaj të afërmit;
- jetojnë në marrëdhënie vëllazërore me të gjithë njerëzit.

## Kush mund të jetë françeskan shekullar (anëtar i UFSH-së)?

Terciarë, apo anëtarë të Urdhrit Françeskan Shekullar, mund të jenë:

- vetëm besimtarët e krishterë, katolikë: djem e vajza, burra e gra, vejanë e vejusha – po edhe meshtarët shekullarë dioqezanë (priftërinjtë) dhe ipeshkvijtë – të cilët dëshirojnë të jetojnë në mënyrë të përsosur Ungjillin e Jezu Krishti, sipas shembullit të Shën Françeskut të Asizit;
- duhet të jenë të pagëzuar, të kunguar dhe të krezmuar; në qoftë se janë martuar, duhet të kenë sakramentin e kurorës së martesës (d.m.th. kurorën kishtare);
- të jenë besnikë ndaj fesë katolike dhe moralit të krishterë;
- duhet të jenë në moshën e pjekurisë(mbi 25 vjeç);
- të jenë në paqe me gjithkënd, njerëz paqedashës, jo ngatërrestarë...;
- të gatshëm për t'u ndihmuar të varfërve, e sidomos të sëmurëve;
- për t'u bërë terciarë, duhet të pranojnë formimin françeskan gjatë një periudhe të sprovës dhe gjatë vitit të noviciatit.

## Përshpirtëria e françeskanëve shekullarë

- Françeskanët shekullarë ("terciarët") çdo ditë i luten Zotit, personalisht dhe familjarisht;
- çdo të diel marrin pjesë në Meshën e Shenjtë;
- zakonisht rrëfehen një herë në muaj;
- zakonisht kungohen çdo herë kur marrin pjesë në meshë;
- vazhdimisht lexojnë, meditojnë dhe në jetë zbatojnë Ungjillin e Zotit tonë Jezu Krishtit;
- dëshmojnë fenë e vet me fjalë e me shembull, e para së gjithash me vepra të mira;
- kultivojnë marrëdhëniet vëllazërore me të gjithë anëtarët e UFSH-së dhe marrëdhëniet miqësore me të gjithë njerëzit vullnetmirë
- jetojnë nga puna e duarve të veta dhe ikin nga papunësia;
- kujdesohen për nevojat e Kishës dhe të vëllazërisë;

- veçanërisht kujdesohen për të sëmurë dhe të varfër;
- angazhohen për paqe dhe drejtësi në botë;
- krijojnë dhe ruajnë ambientin e bukur, të shëndoshë dhe të këndshëm për jetën e njeriut;
- angazhohen për ruajtjen e të gjitha krijesave të Zotit, domethënë, për ruajtjen e natyrës (ekologji).

## Organizimi i UFSH-it

UFSH-ja është organizuar si vëllazëri në shkallë të ndryshme: lokale, krahinore, kombëtare dhe ndërkombëtare. Çdo vëllazëri drejtohet nga **këshilli** i saj, në krye **kryetarin** ("ministrin" – shërbëtorin), sipas Rregullës, Kushtetutave dhe Statuteve.

Përveç kryetarit, këshilli zakonisht e ka edhe nënkryetarin, sekretarin, arkëtarin, përgjegjësin për formim, përgjegjësin për Rininë Françeskane, përgjegjësin për "Bukën e Shën Antonit" (apo për Caritas), si edhe disa këshilltarë dhe këshilltare tjera – sipas Statuteve.

Çdo vëllazëri e UFSH-së duhet të ketë nga një meshtar, si **asistent shpirtëror,** nga Urdhri i Parë Françeskan.

Çdo anëtar i vëllazërisë, brenda mundësive të veta, jep edhe ndihmën materiale, si për nevojat e vëllazërisë, po ashtu edhe për të varfër (për "Bukën e Shën Antonit").

Çdo anëtar i UFSH-së lutet për të gjithë anëtarët e gjallë dhe të vdekur të vëllazërisë.

## Pajtorët e Urdhrit Françeskan Shekullar

1. Zoja e Papërlyer - më 8 dhjetor;
2. Shën Françesku i Asizit - më 4 tetor;
3. Shën Luigji IX (mbret i Francës) - më 25 gusht;

4. Shenjtja Elizabetë e Hungarisë - më 17 nëntor;

5. Shën Lukezi (terciari i parë) - më 28 prill;

6. Shën Margareta e Kortonës - më 22 shkurt.

## NDJESËN E PLOTË

*(Me kushte të zakonshme: rrëfimi, kungimi dhe lutja sipas qëllimit të Papës)*

**terciarët mund ta fitojnë me këto raste:**

1) më 01 janar - Viti i Ri (Zoja e Bekuar Nëna e Hyjit);

2) më 06 janar - Dëftimi i Zotit;

3) më 16 janar - Martirët e parë françeskanë;

4) më 30 janar - Shën Hiacinta Mariscotti;

5) më 01 shkurt - I Lumturi Andre nga Konti;

6) më 06 shkurt - Martirët Japonezë;

7) më 22 shkurt - **Shenjtja Margareta e Kortonës;**

8) më 23 shkurt - Shën Konradi nga Piacenza;

9) më 06 mars - Shenjtja Koleta;

10) më 25 mars - Zoja Nunciatë;

11) më 19 mars - Shën Jozefi;

12) më 25 mars - Lajmërimi i Zojës;

13) më 24 prill - Shën Fideli i Sigmaringenit;

14) më 28 prill - **Shën Lukezi;**

15) më 17 maj - Shën Pashk Bayloni;

16) më 19 maj - Shën Ivoni;

17) më 20 maj - Shën Bernardini i Sienës;

18) më 13 qershor - Shën Antoni i Padovës;

19) më 21 korrik - Shën Lorenci i Brindizit;

20) më 04 korrik - Shenjtja Elizabetë e Portugalisë;

21) më 10 korrik - Shenjtja Veronika Juliani;

22) më 15 korrik - Shën Bonaventura;

23) më 02 gusht - Porciunkulla;

24) më 11 gusht - Shenjtja Kjarë;

25) më 15 gusht - Të Ngriturit e Zojës në Qiell;

26) më 16 gusht - Shën Rroku;

27) më 19 gusht - Shën Ludoviku i Tuluzës, ipeshkëv;

28) më 25 gusht - **Shën Luigji IX;**

29) më 04 shtator - Shën Roza e Viterbos;

30) më 08 shtator - Lindja e Zojës së Bekuar;

31) më 17 shtator - Varrët e shën Françeskut;

32) më 18 shtator - Shën Jozefi nga Kopertino;

33) më 21 shtator - E Lumtura Delfina de Glandeves;

34) më 26 shtator - Shën Elzeari de Sobran;

35) më 29 shtator - Shën Mëhilli;

36) më 04 tetor - **Shën Françesku i Asizit;**

37) më 06 tetor - Shenjtja Maria Françeska;

38) më 10 tetor - Shën Danieli, m.;

39) më 19 tetor - Shën Pjetri nga Alkantara;

40) më 17 nëntor - **Shenjtja Elizabetë e Hungarisë;**

41) më 29 nëntor - Të gjithë Shenjtërit Françeskanë;

42) më 08 dhjetor - **Zoja e Papërlyer;**

43) më 25 dhjetor - Krishtlindja.

44) Ditën e Pashkës;

45) Ditën e të Shëlbuemit;

46) Ditën e Rrëshajëve;

47) Ditën e Trinisë Shenjte;

48) Ditën e Zemrës së Krishtit;

49) Ditën e veshjes (e hyrjes në Noviciat);

50) Ditën e kushteve (premtimeve);

51) Ditën e ripërtëritjes vjetore të kushteve;

52) Ditën e Festës së Kishës;

53) Një ditë gjatë ushtrimeve shpirtërore (vjetore);

54) Kur marrin bekimin e Papës (2 herë në vit);

55) Në momentin e vdekjes.

**Të gjitha ndjesat,** përveç ndjesës së plotë në momentin e vdekjes, mund të kushtohen **edhe për shpirtrat e purgatorit.**

## Lutja e përditshme e shekullarëve françeskanë

1) Besoj-ma Apostolike;
2) 7 Ati Ynë; 7 Të Falemi Mari dhe 7 Lavdi Atit..., në nder të 7 pikëllimeve dhe 7 gëzimeve të Zojës së Bekuar.
3) **Lutja përfundimtare** për ndërmjetësinë e Shën Françeskut:

**O Hyj, Ti bëre që Shën Françesku të kalonte një jetë të përvuajtur e të varfër në përngjasimin e Krishtit. Bëj që – me ndërmjetësinë e tij – edhe ne të ecim gjurmëve të tija, t'i përngjajmë Birit tënd e të bashkohemi me Ty në dashuri të hareshme. Nëpër Krishtin, Zotin tonë. Amen.**

* * *

| | |
|---|---|
| Zoja e Bekuar dhe Shën Jozefi | - lutuni për ne! |
| Shenjtërit apostuj dhe martirët e Krishtit | - lutuni për ne! |
| Shën Françesku dhe Shenjtja Kjarë | - lutuni për ne! |
| Shën Luigji dhe Shenjtja Elizabetë | - lutuni për ne! |
| Të gjithë Engjëjt e Zotit | - lutuni për ne! |
| Të gjithë pajtorët tanë të shenjtë | - lutuni për ne! |

## LUTJA E SHËN FRANÇESKUT

***O Zot, më bëj të jem mjet i paqes Sate:***

*ku ka urrejtje – unë të sjell dashurinë,*

*ku ka fyerje – unë ta sjell faljen,*

*ku ka mospajtim – unë ta sjell bashkimin,*

*ku ka mashtrim – unë ta sjell besimin,*

*ku ka dëshpërim – unë ta sjell shpresën,*

*ku ka terr – unë ta sjell dritën,*

*ku ka pikëllim – unë ta sjell gëzimin.*

***O Zot, bëj që mos të kujdesem aq***

*që të jem ngushëlluar – sa të ngushëlloj,*

*që të më kuptojnë – sa t'i kuptoj unë të tjerët,*

*që të më duan – sa të dua.*

*Sepse: kush dhuron vetveten – e fiton vetveten;*

*kush harron vetveten – e gjen vetveten;*

*kush fal – do t'i falet;*

*kush i vdes vetvetes – lind për jetën e amshuar.*